




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10018, DATË 13.11.2008,
‘PËR AVOKATURËN E SHTETIT’**



*To ndryshon përcaktimet
për ligjin nr. 10018/2008*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kashtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI :

Në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në Pikën 1, togfjalëshi “në varësi të Ministrit të Drejtësisë”, zëvendësohet me “në varësi të Kryeministrit”.
2. Në Pikën 2, fjalia e fundit riformulohet si vijon:
“Asistenca juridike jepet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit”.
3. Në Pikën 2, pas fjalisë së fundit shtohet fjalia:
“Avokatët e shtetit pranë zyrave vendore, përfaqësojnë dhe mbrojnë, pa autorizim, pranë gjykatave ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre.”
4. Pika 4, ndryshohet si vijon:
“Avokatura e Shtetit financohet nga buxheti i shtetit.”

Neni 2

Në nenin 3 bëhet shtesa dhe ndryshimi:

1. Paragrafi në nenin 3 bëhet pika 1.
2. Pas pikës 1, shtohet Pika 2, me këtë përmbajtje:
“2.Asistenca e dhënë dhe marrëdhëniet midis Avokaturës së Shtetit dhe organit të interesuar, janë konfidenciale.”

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 bëhet një shtesë:

Në gërmën “b”, pas togfjalëshit “avokatët e shtetit” shtohet togfjalëshi “ose zyrat e Avokaturës së Shtetit”.
2. Në pikën 5 togfjalëshi “Ministrit të Drejtësisë”, zëvendësohet me togfjalëshin “Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave”.
3. Pika 6, ndryshohet me këtë përmbajtje:
“Mënyra e organizimit dhe bashkërendimit të punës, ndërmjet niveleve dhe zyrave në Avokaturën e Shtetit, përcaktohet në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.”

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike, sipas kushteve të këtij ligji, veçim për personat juridikë të mëposhtëm:
a) Institucionet shtetërore;
b) Entet publike;
c) Shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave.”
2. Në pikën 2, pas shkronjës (c) shtohet pika (ç), me këtë përmbajtje:

“ç) për hartimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të të drejtës publike dhe çështjeve gjyqësore që lidhen me këto procese, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”
3. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në fushën e veprimtarisë së saj, Avokatura e Shtetit është organi ekskluziv, për dhënien e asistencës juridike. Personat juridikë, që përfaqësohen nga Avokatura e Shtetit, nuk

legjitimohen të përfaqësohen vetë në çështjet gjyqësore ku janë palë, përveç kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.”

Neni 5

Në nenin 6, bëhen këto ndryshime:

1. Në gërmat “ë”, “g”, “gj” togfjalëshi “Ministrit të Drejtësisë”, zëvendësohet me “Kryeministrit”.
2. Në gërma “f”, hiqet togfjalëshi “Ministrit të Drejtësisë dhe nëpërmjet tij”.
3. Gërma “h”, ndryshohet me këtë përmbajtje:
“h) përfaqëson, për shkak të detyrës, Republikën e Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e agjentit qeveritar”

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalia e dytë ndryshon si vijon:
“2. Njëri ose disa prej avokatëve të shtetit të kësaj zyre, emërohen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si përfaqësues ligjorë të Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”
2. Në pikën 2, pas fjalisë së 2-të, shtohet fjalia e fundit, me këtë përmbajtje:

“2. Avokatët e Shtetit të kësaj zyre në ushtrimin e funksioneve ndihmohen nga juristë.”
3. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit vetë apo nëpërmjet Përfaqësuesve të Republikës së Shqipërisë (bashkë agjentëve) ushtron funksionin e Agjentit të Qeverisë Shqiptare, pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”
4. Në pikën 4, togfjalëshi “caktohet një nga juristët”, ndryshohet në togfjalëshin “caktohet një ose disa juristë”.
5. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Në rast arbitrazhi ndërkombëtar në fushën e investimeve, ku palë është Republika e Shqipërisë, organi i interesuar, sipas këtij ligji, konsiderohet Ministria përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja.”

Neni 7

Në nenin 11, bëhet një ndryshim:

Në pikën 6, togfjalëshi “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohet nga “Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave”

Neni 8

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Emërtimi i nenit ndryshohet me këtë përmbajtje:
“Avokatët e Shtetit dhe zyrat e Avokaturës së Shtetit pranë ministrive”.
2. Pika 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:
“1. Pranë ministrive krijohen zyra me një ose disa avokatë shteti, të cilët ushtrojnë funksione këshillimore dhe përfaqësimi, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. ”
3. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“3. Avokatët e shtetit ose Zyrat e Avokaturës së Shtetit pranë ministrive kanë varësi administrative dhe funksionale nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.”
4. Pika 4 shfuqizohet.
5. Në pikën 5 pas togfjalëshit “Funksioni këshillimor i avokatëve të shtetit pranë ministrive,” shtohet togfjalëshi “sipas parashikimeve të këtij ligji”.
6. Në pikën 6 hiqet togfjalëshi “Ministrit të Drejtësisë”.
7. Pika 7 riformulohet me këtë përmbajtje:
“7.Trajtimi financiar i avokatëve të shtetit pranë ministrive, mbulohet nga buxheti i Avokaturës së Shtetit.”

Neni 9

Në nenin 14 bëhet një ndryshim.

Në pikën 3, togfjalëshi “1 milion” zëvendësohet me “2 milion”.

Neni 10

Në nenin 15 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“3. Avokatura e Shtetit, kur i kërkohet, jep paraprakisht mendim për projektet e kontratave të organeve të administratës publike, enteve publike dhe shoqërive të krijuara ose që veprojnë sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë

se gjysmën e aksioneve apo kuotave, të subjekteve, ku shteti është pronar i vetëm ose bashkëpronar, si dhe mund t'u përgatisë këtyre kontrata të rëndësishme.”

2. Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Këshillimi paraprak i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për tu kërkuar, në rastet e mëposhtme:

“a) për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat dhe të kontratave të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh;

b) për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të cilat parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

c) kur shfaqen pretendime nga pala private apo institucioni publik në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në rast konflikti interpretimesh apo çdo mosmarrëveshje tjetër në ekzekutimin e kontratave që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

ç) kur shfaqen pretendime nga investitorë të huaj për shkelje nga Republika e Shqipërisë të ligjit, traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve të huaja.”

3. Në pikën 7, togfjalëshi “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohet me “Kryeministri”.

4. Pas pikës 9, shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“Këshillimi mund të delegohet tek organi i interesuar, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Kushtet dhe kriteret për delegimin e këshillimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Në nenin 16, bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 3, në fund të fjalisë, hiqet togfjalëshi “dhe Ministrin e Drejtësisë”.

Neni 12

Në nenin 17, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë, ndryshon me këtë përmbajtje:

“1.Zgjidhja, për të cilën është rënë dakord nga palët, materializohet në një akt, i cili nënshkruhet prej tyre në prani të Avokaturës së Shtetit dhe, i përcillet për miratim Ministrisë përkatëse dhe Ministrisë së Financave.”

Neni 13

Në nenin 18, bëhet një ndryshim:

1. Në pikën “1”, hiqet togfjalëshi “me miratimin e Ministrit të Drejtësisë”.

2. Pika “2” riformulohet si vijon: “Procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/zyrave të avokatisë, për kontraktimin e shërbimeve të tjera ndihmëse në arbitrazh, si dhe për pagesën e tyre përcaktohen me rregullore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.”

Neni 14

Pas nenit 18 shtohen nenet 18/1 dhe 18/2 me këtë përmbajtje:

Neni 18/1

“Vënia në ekzekutim e vendimeve të GJEDNJ-së”

1. Avokatura e Shtetit nëpërmjet Agjentit Qeveritar është organi që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimeve ose urdhërimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
2. Avokatura e Shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkon nga institucionet kompetente vënien në ekzekutim të urdhërimeve që përmban vendimi i formës së prerë apo vendimi i ndërmjetëm i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
3. Avokatura e Shtetit në aktet që përcjell evidenton ndër të tjera, vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që vihet në ekzekutim, identitetin e aplikantëve, llojin dhe masën e urdhërimit të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe institucionet që kanë detyrimin për ekzekutim ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit.
4. Avokatura e Shtetit përcjell aktet, në institucionet që kanë detyrimin për ekzekutim, brenda 15 ditëve kalendarike nga dita e njohimit të vendimit të formës së prerë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe menjëherë nga momenti i vënies në dijeni për vendimet e ndërmjetme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
5. Në rastet kur masat që duhen marrë në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë të paqarta Avokatura e Shtetit i rekomandon organeve kompetente marrjen e masave të caktuara.
6. Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ekzekutohen, nga institucionet që kanë detyrimin për ekzekutim, brenda afatit 3 mujor nga momenti kur vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka marrë formë të prerë.
7. Vendimet e ndërmjetme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ekzekutohen, nga institucionet që kanë detyrimin për ekzekutim, brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe kur del e nevojshme nga rrethanat, sipas udhëzimeve të Avokaturës së Shtetit.

8. Ekzekutimi financiar i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përmbushet drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave, pas përcjelljes të akteve nga Avokatura e Shtetit.
9. Ministria e Financave ruan të drejtën për të kërkuar me padinë e kthimit shumën e lëvruar në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga personi fizik ose juridik përgjegjës për shkaktimin e shkeljes.
10. Organet dhe punonjësit që ekzekutojnë vendimet sipas këtij ligji, janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me vendimet, urdhërimet dhe afateve procedurale të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Neni 18/2

“Marrja e masave të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së”

1. Në rastet kur vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut kërkojnë marrjen e masave të përgjithshme Avokatura e Shtetit përpara hartimit të planeve të veprimit, i komunikon gjetjet e GJEDNJ-së dhe rekomandimet përkatëse, organit përgjegjës të administratës publike, si dhe kërkon prej tyre angazhimin për zgjidhjen e problematikës të konstatuar nga GJEDNJ.
2. Organet e cituara në Pikën I të këtij neni, kanë detyrimin të japin kontributin e tyre në hartimin e planeve të veprimit dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikën e konstatuar nga GJEDNJ brenda 2 muajve nga marrja e kërkesës nga Avokatura e Shtetit.

Neni 15

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime si vijojnë:

1. Titulli i nenit nga “Përfashtimi nga tarifat” bëhet “Aksesi i avokatëve të shtetit”.
2. Avokatura e Shtetit përjashtohet nga detyrimi për pagimin e tarifave gjyqësore dhe shpenzimet e ekspertizës të kryera nga organet shtetërore të ekspertizës si dhe, për veprimet e shërbimet, që kryhen nga organet e administratës publike, administrata gjyqësore, prokuroria dhe përmbaruesi gjyqësor shtetëror.
3. Në rastet kur përfaqësimi i shteti bëhet nga avokatët e shtetit, këto kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata, mbulimin nga pala gjyqësore të kostove të përfaqësimit. Në këto raste kostot e përfaqësimit avokatëve të shtetit do të përlllogariten sipas tarifave në fuqi për avokatët në profesion të lirë. Të ardhurat e krijuara nga ky proces, derdhen në buxhetin e shtetit.
4. Avokatët e shtetit me qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit, kanë akses të plotë në dosjet e gjykatave të rretheve, të apelit dhe gjykatës së lartë, si dhe në çdo institucion tjetër që mund të ketë dokumentacion dhe informacion të nevojshëm. Aksesi në dosjet e gjykatave jepet edhe për verifikimin dhe inspektimin e punës së avokatëve të shtetit.
5. Kur është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shtetit, dëshmia e trashëgimisë e kërkuar nga Avokatura e Shtetit, lëshohet nga gjykata e shkallës së parë.

Neni 16

Neni 20 ndryshohet me këtë përmbajtje:

- “ 1. Avokat i shtetit mund të emërohet çdo shtetas shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:
- a) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
 - b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale, ose të mos jetë larguar nga shërbimi civil apo çdo funksion tjetër publik për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;
 - c) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas dispozitave të ligjit përkatës.
2. Në mungesë të kandidatëve që plotësojnë kushtin sipas pikës 1 gërma a të këtij neni, përkohësisht pranohen kandidatë të cilët:
- a) të jenë të pajisur me diplomë të integruar të nivelit të dytë për drejtësi;
 - b) Të kenë një përvojë pune në gjyqësor ose administratë publike prej të paktën 5 vitesh.
 - c) Në rastin e shtetasit shqiptar, të diplomuar për drejtësi, me rezultate të larta, në universitete të njohura të huaja, apo të diplomuar në shkolla pasuniversitare, kushti i përvojës në punë, i përcaktuar në shkronjën pikën 2 të këtij neni, është të paktën 3 vjet.”

Neni 17

Pas nenit 20 shtohen nenet 20/1, 20/2, 20/3 dhe 20/4 me këtë përmbajtje:

Neni 20/1

Thirrja për aplikime

1. Në Janar të çdo viti, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, pasi ka kryer një analizë të nevojave, përcakton dhe publikon numrin maksimal të kandidatëve për avokatë shteti që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.
2. Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për aplikime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të avokatëve të shtetit sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 20/2

Aplikimi dhe vlerësimi paraprak i aplikantëve

1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit Shkurt të çdo viti.

2. Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji. Nëse është e nevojshme, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nga organet publike dhe/ose punëdhënësi i aplikantit.
3. Deri në datën 15 Mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse aplikanti përmbush kriteret e aplikimit të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji.
4. Shkolla e Magjistraturës në procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për avokat shteti zbaton për aq sa është e mundur kriteret dhe procedurat që zbatohen dhe për kandidatët për prokuror.
5. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak bashkë me dosjet me dokumentat e aplikimit për secilin aplikant. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund të jap komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit Mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar duke konsideruar komentet dhe kundërshtimet e marra dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare.
6. Çdo aplikant ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit të parashikuara në ligjin për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.

Neni 20/3

Provimi

1. Deri në fund të muajit Prill të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës organizon provimin për pranimin në formimin fillestar për të gjithë aplikantët, siç përcaktohet në vlerësim sipas nenit 20/2 të këtij ligji në përputhje me rregullat që parashikon Ligji “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.
2. Shkolla e Magjistraturës harton listën e renditjes së aplikantëve sipas rezultateve të provimit dhe publikon listën e miratuar, deri në datën 15 Maj të çdo viti, duke treguar në listë, numrin maksimal të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar, në përputhje me vendimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, sipas nenit 20/2 të këtij ligji.
3. Çdo aplikant ka të drejtë të drejtë të ushtrojë ankim siç përcaktohet në Ligjin “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

Stazhi profesional i kandidatëve për avokatë shteti

1. Kandidatët për avokatë shteti kryejnë stazhin përkatësisht, pranë Zyrave përkatëse, në nivel qendror dhe vendor të Avokaturës së Shtetit, në vitin e tretë të formimit fillestar. Stazhi zgjat 12 muaj, duke filluar në korrik dhe përfundon në qershor të vitit pasardhës.
2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit përcakton Zyrat respektive, për kryerjen e stazhit profesional për kandidatët për avokatë shteti, bazuar në këto tregues:
 - a) disponueshmërinë e avokatëve të shtetit udhëheqës,
 - b) infrastrukturën e Zyrave të Avokaturës së Shtetit,
 - c) disponueshmërinë e hapësirës së punës dhe ambienteve për kandidatët avokatë shteti, dhe
 - ç) mundësinë për t'u njohur me një numër të madh ligjesh dhe shumëllojshmëri çështjesh gjatë stazhit.
3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit zgjedh një trup avokatësh shteti udhëheqës, me një kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të drejtë rizgjedhje. Çdo avokat shteti udhëheqës duhet të përmbushë njëkohësisht këto kritere:
 - a) të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë si avokat shteti,
 - b) të jetë vlerësuar në përputhje me këtë ligj, të paktën 'shumë mirë' në vlerësimin e fundit të veprimtarisë etike dhe profesionale, në mënyrë të veçantë për kriterin e aftësive organizative;
 - c) të mos ketë masa disiplinore;
4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton udhëheqës për secilin prej kandidatëve për avokatë shteti, me qëllim që secili prej tyre:
 - a) të ketë udhëheqës të ndryshëm për secilën nga tre periudhat katër mujore të njëpasnjëshme;
 - b) të fitojë përvojë profesionale në fushat e së drejtës;
 - c) të përfshihet sa më shumë që është e mundur në aspekte të punës së përditshme të avokatit të shtetit.
5. Avokati udhëheqës vlerëson veprimtarinë etike dhe profesionale të secilit kandidat për avokatë shteti, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në këtë ligj.
6. Gjatë stazhit, kandidati për avokat shteti gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Pushimet vjetore, jepen pas konsultave me avokatin udhëheqës të kandidatit për avokat shteti.
7. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit harton rregulla të përbashkëta për caktimin e Zyrave dhe avokatëve të shtetit udhëheqës për programin e stazhit, vlerësimin e veprimtarisë etike, profesionale si dhe cilësisë së kandidatëve për avokatë shteti, me qëllim që të garantohet një formim sa më i mirë i tyre.

Neni 18

Neni 21, ndryshohet me këtë përmbajtje:

- “ 1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit emërohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit nga radhët e juristëve të shquar që kanë të paktën 10 vjet përvojë në profesion.
2. Kandidatët për avokat shteti që përfundojnë studimet në shkollën e Magjistraturës, emërohen në detyrë me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
3. Shkolla e Magjistraturës në procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për avokat shteti zbaton për aq sa është e mundur kriteret dhe procedurat që zbatohen dhe për kandidatët për prokuror.
4. Marrëdhënia e punës për kandidatët e parashikuar në pikën 2 të nenit 20, do të jetë e përkohshme, deri në paraqitjen e kandidaturave sipas pikës 1, gërma a të nenit 20, por jo më tepër se tre vjet nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore.
5. Drejtuesit e strukturave të Avokaturës së Shtetit, në të dyja nivelet, emërohen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, nga radhët e avokatëve të shtetit.”

Neni 19

Në neni 22 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, togefjalëshi “njëri prej drejtuesve të zyrave në Avokaturën e Shtetit” zëvendësohet me këtë përmbajtje “njëri prej avokatëve të shtetit”.
2. Në pikën 2, togefjalëshi “me propozim të Ministrit të Drejtësisë” zëvendësohet me “Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave”.

Neni 20

Në nenin 23 në fund të fjalisë shtohet togefjalëshi, “me përjashtim të veprimtarive akademike e të mësimdhënies.”

Neni 21

Në nenin 24 bëhet një ndryshim:

1. Pika 2, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si dhe çdo Avokat Shtetit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre i përmbahen dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.”

Neni 22

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshon me këtë përmbajtje:
“3. Lirimi ose shkarkimi nga detyra i avokatit të shtetit dhe i drejtuesit të strukturave të Avokaturës së Shtetit, bëhet me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.”
2. Pika 4, ndryshon me këtë përmbajtje:
“4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lirohet ose shkarkohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit.

Neni 23

Pas kreut VI, shtohet kreu VI/I me përmbajtje si më poshtë vijon:

“KREU VI/I STATUSI DHE KARRIERA E AVOKATIT TË SHTESTIT

Neni 26/1 Statusi i Avokatit të Shtetit

1. Avokatët e Shtetit, të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji, gjatë kohës së qëndrimit në detyrë kanë statusin e Avokatit të Shtetit.
2. Statusi i Avokatit të Shtetit, për qëllim të këtij ligji, përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e avokatit të shtetit.

Neni 26/2 Ruajtja e statusit të Avokatit të Shtetit

1. Avokatët e Shtetit pezullohen dhe nuk e humbasin statusin e “Avokatit të Shtetit”, në rastet kur:
 - a) me kërkesën e tyre dhe me miratim të Avokatit të Përgjithshëm shërbejnë për një afat deri në tre vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjorë ose këshilltarë të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, prokurorë, pedagogë ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Trajtimi financiar i Avokatit të Shtetit gjatë kësaj periudhe, bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë.
 - b) Me kërkesë dhe me miratim të Avokatit të Përgjithshëm, i nënshtrohen studimeve apo trajnimeve të posaçme, për periudha jo më tepër se tre vjet. Gjatë periudhës së pezullimit për këtë shkak, avokatët e shtetit nuk paguhen.
2. Në përfundim të afatit të përcaktuar në gërmat a dhe b të këtij neni, avokatët e shtetit kthehen brenda strukturës së Avokaturës së Shtetit. Në mbarim të afateve të mësipërme dhe me kërkesën e tyre, ata riemërohen Avokatë Shteti, pa konkurs, në të njëjtin nivel që kanë pasur.

3. Avokatët e Shtetit, që nuk kanë kërkuar të kthehen brenda strukturës sipas parashikimeve të mësipërme e humbasin statusin që gëzojnë. Në rast se kërkojnë rikthimin pranë Avokaturës së Shtetit pas kalimit të këtij afati, ata duhet t'i nënshtrohen sërish kërkesave për pranim në institucion siç parashikohet në këtë ligj.
4. Periudha e pezullimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si Avokat Shteti, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.
5. Avokatët e Shtetit nuk e humbasin titullin "Avokat Shteti" në rastet e largimit nga detyra me pëlqimin e tyre dhe kanë të drejtë të rikthehen përsëri në strukturat e Avokaturës së Shtetit, sipas procedurave të pikës 3 të këtij neni.

Neni 26/3

Ngritja në detyrë, ulja në detyrë dhe transferimi

1. Çdo avokat shteti, me kërkesë me shkrim mund të kërkojë ngritje në detyrë për tu emëruar në nivel qendror, ose drejtues zyre në rast se plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) ka ushtruar detyrën avokat shteti në nivel vendor për një afat jo më të shkurtër se pesë vjet;
 - b) puna e tij gjatë pesë viteve të fundit është vlerësuar jo më pak se tre herë "shume mirë" dhe herët e tjera jo më ulët se "mirë".
2. Për avokatët e shtetit që mbajnë gradën shkencore "doktor i shkencave në fushën juridike" kriteri i kërkuar në shkronjën "a", të pikës 1 të këtij neni bëhet tre vjet.
3. Kur për çdo vend vakant konkurrojnë dy apo më shume kandidatë, Avokati i Përgjithshëm mbi bazën e treguesve të secilit kandidat si edhe, duke pasur parasysh përvojën në punë emëron avokatin më të përshtatshëm.
4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, për nevoja pune që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë në staf apo mbingarkesën në punë, mund të transferojë një ose më shumë Avokat Shteti të nivelit qendror ose vendor, brenda të njëjtit nivel, ose në një nivel më të ulët, për nevoja pune edhe pa pëlqimin e tyre, për një periudhë deri në gjashtë muaj. Me mbarimin e kësaj periudhe Avokati i Shtetit i komanduar kthehet në pozicionin e mëparshëm. Gjatë kohës së komandimit Avokatët e Shtetit vazhdojnë të paguhen me pagën dhe të përfitojnë shpërblimet sipas nivelit në të cilin bëjnë pjesë.

Neni 26/4

Ngritja profesionale

1. Avokatët e Shtetit kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në trajnime periodike për ngritjen e nivelit të tyre profesional.
2. Avokatëve të Shtetit iu vihet në dispozicion Fletorja Zyrtare, literatura juridike dhe shërbimi i internetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 26/5

Dokumenti i identifikimit

Avokati i Shtetit pajiset me dokument identifikimi. Forma dhe përmbajtja e dokumentit përcaktohen me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 26/6
Ruajtja e të dhënave

Avokatëve të Shtetit u ndalohet të bëjnë publike ose t'u japin personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në proces gjykimimi ose këshillimi, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

Neni 26/7
Koha e punës

1. Koha javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të punonjësve të administratës publike.
2. Në rast nevojë, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, Avokati i Shtetit është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit, në ditët e pushimit javor, të festave ose kur është duke kryer lejen vjetore.

Neni 26/8
Leja vjetore

Avokati i Shtetit gëzon të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore, si rregull, bëhet në muajt korrik dhe gusht.

Neni 26/9
Leja për raste të veçanta

1. Për nevoja të veçanta, vetjake ose familjare, avokati i shtetit ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.
2. Në raste martesash ose vdekjesh brenda familjes, kur është konsumuar koha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Avokati i Shtetit ka të drejtë të përfitojë deri në 10 ditë leje të paguara.

Neni 26/10
Trajtimi dhe statusi protokollar

1. Avokati i Shtetit dhe drejtuesit e tyre kanë të njëjtat trajtime dhe status protokollar si prokurorët pranë Gjykatave të Apelit, pranë të cilave ushtrojnë funksionet avokati i shtetit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.
2. Avokati i Shtetit dhe drejtuesit e tyre, në nivel qendror kanë të njëjtat trajtime dhe status protokollar si prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka të njëjtat trajtime dhe status protokollar si Prokurori i Përgjithshëm i Republikës.”

Neni 24

Neni “27” emërtohet “Paga, shpërblimet dhe trajtimet” dhe, ndryshohet me këtë përmbajtje:

- “ 1. Paga e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është e barabartë me pagën e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Paga e Drejtuesve të Zyrës në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit është e barabartë me pagën e Drejtuesve të Sektorëve në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Paga e Avokatëve të Shtetit në nivel qendror është e barabartë me pagën e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.
4. Paga e Kryetarëve të Zyrave Vendore është sa paga e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit përkatëse.
5. Paga e Avokatëve të Shtetit në nivel vendor është sa paga e Prokurorit pranë Gjykatës së Apelit përkatëse.
6. Në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, Avokati i Shtetit, që kryen detyra të ngutshme përfiton shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.
7. Paga e punonjësve të administratës mbështetëse rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 25

Në nenin 28 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Emërtimi i nenit “Fondi i Shpërblimit” zëvendësohet me emërtimin “Krijimi i fondit dhe shpërblimi i avokatëve të shtetit”
2. Përmbajtja e Nenit 28 ndryshohet:
 - “1. Në Buxhetin e Avokaturës së Shtetit, krijohet një zë i veçantë, në masën 10% të Buxhetit të Avokaturës së Shtetit.
 2. Për çështje gjyqësore të veçanta, të vështira dhe me interes të madh ekonomik e financiar për Republikën e Shqipërisë, nga zëri i buxhetit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, avokatit të shtetit i jepet shpërblim i posaçëm.
 3. Klasifikimi i çështjeve, kriteret, mënyra dhe procedurat e përdorimit të këtij zëri, për shpërblimin e avokatëve të shtetit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 26

Në nenin 32, pika e parë riformulohet si vijon:

- “1. Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj avokatit të shtetit, e ka Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në përputhje me rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit.”

Neni 27

Pas nenit 32 shtohet neni 32/1 me këtë përmbajtje:

Neni 32/1 Komisioni i disiplinës

1. Komisioni i Disiplinës është organi kompetent që shqyrton procedimin disiplinor
2. Komisioni i disiplinës përbëhet nga Kryetarët e Zyrave në nivel qendror, me përjashtim të Zyrës së Inspektimit dhe drejtohet nga Kryetari i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat Kombëtare.
3. Në rastet kur procedimi disiplinor fillon për një nga anëtarët e Komisionit, atëherë ai zëvendësohet nga Avokati i Shtetit më i vjetër në detyrë, në nivel qendror.
4. Pasi shqyrton propozimin dhe dëgjon punonjësën për të cilin është propozuar marrja e masës disiplinore, Komisioni i Disiplinës merr vendim, të arsyetuar, të cilin ja propozon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
5. Vendimet e Komisionit miratohen me votat e shumicës së anëtarëve.
6. Raporti i mbledhjes së Komisionit nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit të Disiplinës dhe i bashkangjitet vendimit të Komisionit të Disiplinës që i paraqitet Avokatit të Përgjithshëm.
7. Rregulla më të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Disiplinës, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit.

Neni 28

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:
“2. Deri në miratimin e rregullore së brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, me ndryshimet përkatëse, zyrat në nivel qendror dhe vendor të Avokaturës së Shtetit ushtrojnë të gjitha kompetencat e parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.
2. Pika 3 shfuqizohet.
3. Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“3. Të gjithë avokatët e shtetit në detyrë do t'i nënshtrohen, fazave të detyrueshme trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës dhe provimit përfundimtar për marrjen e titullit Avokat Shteti. Një procedurë e tillë duhet të përfundojë brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit. Përfshihen nga ky detyrim të gjithë avokatët e shtetit, të cilët aktualisht gëzojnë statusin e magjistratit, gjyqtarit dhe prokurorit.”
4. Pas Pikës 4, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:
“4. Fondet e nevojshme për realizimin e trajnimit fillestar dhe trajnimin vazhdues mbulohen nga buxheti i Avokaturës së Shtetit.”
5. Pika 5, ndryshon me këtë përmbajtje:
“5. Rregullat për organizimin e provimit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni përcaktohen me Memorandum midis Avokaturës së Shtetit dhe Shkollës së Magjistraturës. Këto rregulla referojnë për atë sa është e mundur tek rregullat për

ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët e Gjykatës së Lartë, të përcaktuara në Ligjin “Për Qeverisjen e gjyqësorit.”

Neni 29

Neni 36 riformulohet si vijon:

Aktet Nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në Rregulloren që përcakton marrëdhëniet ndërmjet Avokaturës së Shtetit, institucioneve shtetërore dhe enteve publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si edhe normat procedurale të posaçme.
2. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 30

Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI